

FUSHATA PËR PËRDORIM RACIONAL TË ANTIBIOTIKËVE

JENI FTOHUR? KENI GRIP? PUSHONI DHE MJEKOHUNI, POR PA ANTIBIOTIKË!



ANTIBIOTIKËT NUK JAN USHQIM

Mos përdorni antibiotikë pa këshilluar mjekun!

Për shkak të përdorimit të tepërt dhe joadekuat të antibiotikëve efekti i tyre është zvogëluar. Prandaj, duhet ta evitojmë përdorimin e panevojshëm të antibiotikëve. Për shembull, në rast të ftohjes së zakonshme antibiotikët nuk veprojnë. Mjeku juaj e di se kur duhet të pranoni antibiotikë.

Si ta parandaloni përhapjen e infeksioneve më të shpeshta?

Më të shpeshta janë infeksionet e rrugëve të sipërme të frymëmarrjes që në të shumtën e rasteve shkaktohen nga viruset. Ftohje mund të pësoni edhe disa herë gjatë vitit. Një nga masat më kryesore që mund të ndërmerri për parandalimin e përhapjes së infeksioneve është larja e duarve, sepse gjatë të folurit, teshtitjes apo kollitjes viruset dhe bakteret bien në sipërfaqet përreth dhe përmes duarve përhapen edhe më tej. Përhapja e mikroorganizmave do të zvogëlohet nëse gjatë teshtitjes dhe kollitjes mbuloni hundën dhe gojën me një fasuletë.

Pas përdorimit të fasuletës duart duhet të lahen ose të dezinfektohen. Nëse nuk keni fasuletë kur teshtini apo kur kolliteni, hundën edhe gojën mund ta mbuloni me pjesën e sipërme të mëngëve sepse me ato pjesë nuk do të prekni sipërfaqe të tjera.



МИНИСТЕРСТВО ЗА ЗДРАВСТВО
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА



Институт
за јавно здравје



Институт за
микробиологија и
паразитологија,
Медицински факултет,
Скопје



ФЗМ
Фонд за здравствено
осигурување на
Македонија



Центар за регионални истражувања и соработка

**ANTIBIOTIKËT NUK JAN USHQIM QË TË ZGJIDHET
PA KONSLUTUAR MJEKUN. CDO PËRDORJE E PADUHUR E
ZVOGËLON EFIKASITETIN E TYRE**

